

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës
Nr. 02-60/21-07
Prishtinë, më 14 e 17 shtator 2007
Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmuan **Gazmend Muhaxheri** dhe **Naim Maloku**, anëtarë të Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 74 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Seanca i zhvilloi punimet me këtë

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 27 gushtit 2007;
2. Koha për pyetje parlamentare;
3. Interpelanca e ministrit të Arsimit, z. Agim Veliu, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-s;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën jokontestimore;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën përmbartuese;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën kontestimore;
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtat dhe për përgjegjësitë e deputetit;
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin;
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë organike;
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor;
12. Shqyrtimi i propozimit të partive parlamentare për anëtarë në Komisionin Ad Hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së;
13. Shqyrtimi i propozimit të partive parlamentare për anëtarë në Komisionin Ad Hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur për Media;

14. Shqyrtimi i Rekomandimit për tranferin e mjeteve buxhetore të Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (MBPZHR)
15. Shqyrtimi i Rekomandimit për tranferin e mjeteve buxhetore të Ministrisë për Energji dhe Miniera (MEM) në Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit;
16. Shqyrtimi i rekomandimit lidhur me Raportin fiskal për gjashtëmujorin e parë të vitit 2007;
17. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit të Bordit Drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

Në fillim të seancës, **kryetari** i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës së Kuvendit e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Ndërkohë, nuk ka pasur asnjë propozim me shkrim për ta amendamentuar rendin e ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 27 gushtit 2007

Procesverbali i seancës plenare të 27 gushtit 2007 u miratuan pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Xhelal Canziba** i parashtoi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme lidhur me pajisjen e prestarëve të SHPK-së me armë të gjata.

Ministri **Blerim Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Canziba.

Deputeti **Nait Hasani** i parashtoi pyetje ministrit për Kthim dhe Komunitet lidhur me heqjen e tabelave të makinave të Ministrisë gjatë një vizite në veriun e Mitrovicës.

Ministri **Branislav Grbiq** nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja **Sala Ahmetaj** i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit lidhur me ndërtimin e shkollave nëpër ato vende ku mësimi ende zhvillohet nëpër kontejnerë.

Ministri **Agim Veliu** iu përgjigj pyetjes së deputetes Ahmeti.

Deputeti **Hydaje Hyseni** i parashtoi pyetje Qeverisë së Kosovës dhe ministrit të Pushtetit Lokal lidhur me krijimin e kushteve: repetitorëve për pranimin e sinjalit televiziv të Televizionit Publik; lidhjet telefonike de rrugët për banorët e Restelicës me rrethinë.

Përgjigja mbeti për seancën e ardhshme.

Deputeti **Hydajet Hyseni** i parashtoi pyetje Qeverisë së Kosovës dhe ministrit për Kthim dhe Komunitete lidhur me krijimin e parakushteve të nevojshme për banorët e shpërngulur me dhunë nga komunitatet e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjes, si dhe për kthimin e tyre në vatrat e veta.

Përgjigja mbeti për seancën e ardhshme.

Deputeti **Jonuz Kastrati** i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit lidhur me regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme në komunën e Malishevës.

Ministri **Agim Veliu** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kastrati.

Deputetja **Safete Hadërgjonaj** i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me veprimet e Qeverisë për respektimin e ligjeve nga ana e shfrytëzuesve të buxhetit të Kosovës.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadërgjonaj.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i parashtoi pyetje ministrit të Tregtisë dhe Industrisë lidhur me vazhdimin e veprimtarive në ndërmarrjet e privatizuara dhe kthimin e punëtorëve në vendet e punës.

Ministri **Bujar Dugolli** nuk ishte i pranishëm për t'iu përgjigj deputetit Kelmendi.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtoi pyetje ministrit të Transportit dhe të Posttelekomunikacionit lidhur me mirëmbajtjen dhe asfaltimin e rrugëve në komunën e Vitisë.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me veprimet e Qeverisë për t'i zgjidhur problemet në Institutin Albanologjik.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me veprimet e Qeverisë për ta garantuar dhe mbrojtur lirinë, sigurinë dhe tërësinë e territorit të Kosovës.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtoi pyetje ministres së Shërbimeve Publike lidhur me regjistrimin e popullsisë në Kosovë.

Ministrja **Melihate Tërmkolli** nuk ishte e pranishme për t'iu përgjigjur deputetit Bislimi.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtoi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme lidhur me përdorimin e vulës apostile nga ana e kësaj Ministrie.

Ministri **Blerim Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi.

Deputetja **Teuta Hadri** i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë pse i dërgojnë pacientët për mjekim jashtë vendit e nuk i dërgojnë në klinikat vendore private?

Ministri **Sadik Idriz** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadri.

Deputeti **Nait Hasani** i parashtoi pyetje ministrit të Drejtësisë lidhur me mbajtjen në Burgun e Dubravës të Kiçinës dhe Bedri Zymberaj .

Ministri **Jonuz Salihaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hasani.

Deputeti **Berat Luzha** i parashtroi pyetje ministrit të Drejtësisë pse po vonohet procedura gjyqësore e shkallës së dytë nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës, për Grupin e Kaçanikut?

Ministri **Jonuz Salihaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Luzha.

Deputeti **Berat Luzha** i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me mbylljen e deponimë në fshatin Stagovë, komuna e Kaçanikut.

Ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjes së deputetit Luzha.

Deputetja **Sala Berisha-Shala** i kishte parashtruar pyetje ministrit të Ekonomisë dhe Financave, Haki Shatri, sa i kushton buxhetit të Kosovës shkollimi i shërbyesve civilë në fakultete private?

Deputetja Shala nuk ishte e pranishme në seancë.

3. Interpelanca e ministrit të Arsimit, z. Agim Veliu, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-s

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të ORA-s ta marrë fjalën.

Deputeti **Genc Gorani**, në emër të parashtruesit të mocionit, tha se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, më 25 qershor 2007 ka nxjerr Udhëzimin Administrativ, nr. 12/2007 për organizimin e mësimit të klasave të pestave sipas sistemit të ri arsimor.

Partia Reformiste ORA, së bashku me një numër të prindërve, mësimdhënësve dhe të ekspertëve, ka analizuar situatën e krijuar në këtë lëmi. Kemi ardhur në përfundim se ka mungesë të një transparence elementare të Ministrisë në lidhje me përgatitjet dhe rrjedhat e reformës së klasave të pesta.

Organizimi i ri i mësimit në klasat e pesta përfshin më shumë se 36 mijë nxënës, në mbi 1.600 paralele, me 1.600 mësimdhënës aktual dhe një numër të madh të atyre që do të duhet të punësohen.

Në vazhdim, deputeti **Gorani** kërkoi nga ministri Veliu që t'i përgjigjet lidhur me planin e veprimit për realizimin e reformës së klasave të pesta; takimeve të realizuara me këshillat e shkollave; kërkesat e prindërve të nxënësve; nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ me vonesë; tekstet shkollore për klasat e pesta; për rekrutimin e arsimtarëve në klasët e pesta dhe trajnimin e tyre, si dhe për koston e zbatimit të kësaj reforme.

Kryetari e ftoi ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ta marrë fjalën.

Ministri **Agim Veliu** tha se Qeveria e Kosovës e ka deklaruar arsimin ndër tri prioritete kryesore dhe Ministria e Arsimit ka ndërmarrë të gjitha masat për ta zbatuar këtë prioritet dhe për të ndërtuar një sistem bashkëkohor të arsimit.

Bazuar në Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm, që nga viti 2002, është ndryshuar struktura e sistemit arsimor në Kosovë nga 4-4-4 në 5-4-3 që është pesë vjet arsimi fillor, katër vjet arsimi i mesëm i ulët dhe tri vite arsimi i mesëm – i lartë.

Kjo strukturë e re, është në përputhje me sistemin e arsimit në shumicën e vendeve evropiane.

Reforma me klasat e pesta këtë vit shkollor është vetëm vazhdimësi dhe përmbyllje e reformës të filluar me klasën e parë në vitin 2002/2003.

Nxënësit që kanë filluar në klasën e parë në vitin 2002/2003, këtë vit arrijnë në klasën e pestë dhe ne kemi për obligim që atyre t'u ofrojmë arsim sipas strukturës së re.

Ministria i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të përmbyllur me sukses ciklin e reformës me klasën e pestë.

Së pari, Ministria ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ 12/2007 dt. 25.06.2007, i cili përmban të gjitha udhëzimet e nevojshme që kanë të bëjnë me organizimin e mësimimit në klasën e pestë. Së dyti, planprogramet për klasën e pestë janë publikuar qysh në janar të vitit 2006. Së treti, gjatë vitit shkollor 2006/2007 janë hartuar edhe tekstet mësimore për klasën e pestë. Së katërti, Ministria ka bërë trajnimin e mësimeve për klasën e pestë në secilën komunë. Së pesti, komunat kanë zgjedhur kuadrin arsimor për klasën e pestë në pajtim me Udhëzimin administrativ 12/2007.

Rezultatet e kësaj reforme priten të shihen kur do të kemi arritje më të larta në testin kombëtar të këtyre nxënësve, kur ata të arrijnë në klasën e nëntë.

Arsimi, gjithnjë, zhvillohet në një kontekst ekonomik e shoqëror, prandaj nuk duhet pritur që në arsim të realizohen standarde që tejkalojnë mundësitë tona materiale.

Klasa e pestë ka qenë mjaft e kushtueshme për buxhetin e Kosovës, por kjo është një domosdoshmëri dhe obligim që kemi ndaj fëmijëve tanë. Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Arsimit janë të përkushtuara që këtyre fëmijëve t'u sigurojnë arsim cilësor dhe sipas standardeve më të mira ndërkombëtare, si rrugë e vetme për një të ardhme të sigurt të tyre.

Pastaj, **kryetari** e hapi debatin.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me interpelancën e ministrit **Agim Veliu** dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Enver Hoxhaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Mazllom Kumnova**, në emër të Grupit Parlamentar 6+, **Mahir Yagcilar**, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Fatmire Mulhaxha**, **Fatmir Rexhepi**, **Zylfije Hundozi**, **Myrvete Dreshaj-Baliu**, **Sabri Hamiti**, **Teuta Sahatqija**, **Xhezair Murati**, **Fetah Berisha**, **Besa Gaxheri**, **Ferid Agani**, **Gjylshene Berisha dhe Xhevat Bislimi**, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, ministri **Agim Veliu** iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve.

Në fund, deputeti **Genc Gorani**, në emër të parashtruesit të interpelancës, tha se për shumë çështje që i ka ngritur në interpelancë nuk ka marrë përgjigje nga ministri i Arsimit.

Ai, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, kërkoi që Kuvendit ta miratojë këtë

REKOMANDIM

Të shtyhet zbatimi i Udhëzimit Administrativ nr. 12/2007 në vitin shkollor 2008, për shkak të përgatitjeve të pamjaftueshme për zbatimin e tij, pasojave të rënda negative ndaj nxënësve, arsimtarëve dhe procesit mësimor në përgjithësi dhe për t'i siguruar kushtet paraprake optimale për realizimin e suksesshëm të përmbylljes së kësaj reforme.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të ORA-s. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 11;
Kundër---- 39.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, nuk e miratoi Rekomandimin e Grupit Parlamentar të ORA-s.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën jokentestimore

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Drejtësisë, **Jonuz Salihaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Salihaj** e arsyetoi qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për procedurën jokentestimore, pjesën përfundimtare, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ana e ministri **Salihaj**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Sadudin Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Hydajet Hyseni**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Syla**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Teuta Sahatqija**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Vezira Emrush**, të cilat i janë bashkangjitur trasnkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 53;
Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për procedurën jokentestimore.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese - Komision Përgjegjës Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën përmbarese

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Drejtësisë, **Jonuz Salihaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Salihaj** i arsyetoi qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për procedurën përmbarese, pjesën përfundimtare, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ana e ministri **Salihaj**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Nekibe Kelmendi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Hydajet Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjynaze Syla**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Teuta Sahatqija** dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Milazim Haliti**, të cilat i janë bashkangjitur trasnkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 60;

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për procedurën përmbarese.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese - Komision Përgjegjës Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën kontestimore

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Drejtësisë, **Jonuz Salihaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Salihaj** i arsyetoi qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për procedurën kontestimore, pjesën përfundimtare, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ana e ministri **Salihaj**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Sadudin Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Hydajet Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjynaze Syla**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Teuta Sahatqija** dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Fadil Geci**, të cilat i janë bashkangjitur trasnkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 59;

Kundër----- 4.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për procedurën kentestimore.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese - Komision Përgjegjës Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtat dhe për përgjegjësitë e deputetit

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Deputeti **Hydajet Hyseni**, në emër të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj.

Në vazhdim, kryetari i Komisionit Legjislativ, **Hydajet Hyseni**, e arsyetoi qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ana e deputetit **Hyseni**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Gani Koci**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Syla**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Nazim Jashari**, në emër të Grupit Parlamentar 6+, **Husnija Beshković**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi**, në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, **Ferid Agani**, si dhe deputetët: **Sabri Hamiti**, **Naxhije Doçi**, **Nekibe Kelmendi**, **Fatmir Rexhepi**, **Behxhet Brajshori**, **Fetah Berisha** dhe **Xhevat Bislimi**, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 72;

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për të drejtat dhe për përgjegjësitë e deputetit.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese - Komision Përgjegjës Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor, z. **Ardian Gjini**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Gjini** shpjegoi materien, objektivat, strukturën e Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ministri **Gjini**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Shaban Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Selviqe Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Mazllom Kumnova**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Teuta Sahatqija**, në emër të Grupit Parlamentar 6+, **Rifat Krasniq**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integritim, **Ferid Agani**, si dhe deputetja **Naxhije Doçi**, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 62;

Kundër----- 1;

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash e miratoi në parim Projektligjin për vlerësimin strategjik mjedisor.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën e sotme në orën 16:40 minuta.

E hënë, më 17 shtator 2007

Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit të Kosovës, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Të pranishëm ishin 70 deputetë.

Në fillim të seancës, deputeti **Ramadan Kelmendi** kërkoi, si çështje urgjente, që Kuvendi të diskutojë për çështjen e sigurisë në Veriun e Mitrovicës

Pas diskutimeve të anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit: **Xhavit Haliti** dhe **Sabri Hamiti**, Kuvendi nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme ta përgatisë dhe Kuvendit t’ia dërgojë një Informatë lidhur me gjendjen e sigurisë në Mitrovicë, pas rrënimit të Pllakës Përkujtimore të dëshmorit Avni Harjedini.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin

Amendamentet e paraqitura nga ana e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në Projektligjin për ushqimin parashihnin themelimin e Agjencisë së Ushqimit në kuadër të Zyrës së kryeministrit, kurse ato të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e parashihnin themelimin e saj në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë.

Meqenëse se këto dy komisione nuk kishin arritur t’i harmonizonin qëndrimet lidhur me amendamentet e propozuara në Projektligjin për ushqimin, Kuvendi, me shumicë votash, vendosi ta shtyjë shqyrtimin e tij për një seancë tjetër, derisa komisionet t’i harmonizojnë qëndrimet lidhur me themelimin e Agjencisë së Ushqimit.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë organike

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim hapësinor lidhur me Projektligjin për bujqësinë organike.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12(b).

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----66;

Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi unanimisht Ligjin për bujqësinë organike.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Kryetari i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----64;

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor.

12. Shqyrtimi i propozimit të partive parlamentare për anëtarë në Komisionin Ad Hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së

Kuvendi, pasi i shqyrtoi propozimet e partive parlamentare, mori këtë

V E N D I M

Për formimin e Komisionit Ad Hoc për emërimin e anëtarëve të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës

1. Anëtarë të Komisionit Ad Hoc për emërimin e anëtarëve të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës emërohen këta kandidatë:

1. Ramdan Musliu, anëtar, LDK,
2. Hajredin Kuçi, anëtar PDK,
3. Mazllom Kumnova, anëtar, AAK,
4. Ylber Hysa, anëtar, ORA,
5. Lulzim Zeneli, anëtar, LDD,
6. Xhezair Murati, anëtar, VAKAT,
7. Mahir Yagcilar, anëtar, KDTK,
8. Emrush Xhemajli, anëtar, LPK,
9. Gjergj Dedaj, anëtar, PLK,
10. Ferid Agani, anëtar, PD,
11. Zylfi Merxha, anëtar, PRBK,
12. Numan Baliq, anëtar, SDA,
13. Vezira Emrush, anëtare, GIG,
14. -----SLKM,
15. Mark Krasniqi, anëtar, PSHDK,
16. Bislim Hoti, anëtar, IRDK,
17. ----- PDAK dhe
18. ----- GIS.

2. Mandati i këtij Komisioni është që të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve dhe Kuvendit t'ia propozojë listën e anëtarëve të Bordit të RTK-së, jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas vlerësimit të tyre.

13. Shqyrtimi i propozimit të partive parlamentare për anëtarë në Komisionin Ad Hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur për Media

Kuvendi, pasi i shqyrtoi propozimet e partive parlamentare, mori këtë

V E N D I M

Për formimin e Komisionit Ad Hoc për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave

1. Anëtarë të Komisionit Ad Hoc për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave emërohen këta kandidatë:

1. Naim Jerliu , anëtar, LDK,
2. Fehmi Mujota, anëtar, PDK,
3. Myrvete Dreshaj-Baliu, anëtare, AAK,
4. Fatmire Mulhaxha, anëtar, ORA,
5. Besa Gaxheri, anëtare, LDD,
6. Rifat Krasniq, anëtar, PDTK,
7. Emrush Xhemajli, anëtar, LPK,
8. Gjergj Dedaj, anëtar, PLK,
9. Ferid Agani, anëtar, PD,
10. Xhezair Murati, anëtar, VAKAT,
11. Zylfi Merxha, anëtar, PBRK,
12. Numan Baliq, anëtar, PVD,
13. Veizra Emrush, anëtare, GIG,
14. -----SLKM,
15. Zef Morina, anëtar, PSHDK,
16. Xhevdet Neziraj, anëtar, IRDK,
17. -----PDAK dhe
18. -----GIS.

2. Mandati i këtij Komisioni është që të bëjë përzgjedhjen kandidatëve dhe Kuvendit t'ia propozojë listën e anëtarëve të Këshillit të KPM-së, jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas vlerësimit të tyre.

14 Shqyrtimi i Rekomandimit për transferin e mjeteve buxhetore të Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Kuvendi, pasi e shqyrtoi kërkesën e Ministrisë dhe rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, mori këtë

V E N D I M

Miratohet kërkesa e Ministrisë së Bujqësisë për bartjen e mjeteve financiare, në shumën prej 300.000,00 €, nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë e subvencioneve.

15. Shqyrtimi i Rekomandimit për transferin e mjeteve buxhetore të Ministrisë për Energji dhe Miniera (MEM) në Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit

Kuvendi, pas diskutoi për transferin e mjeteve buxhetore nga Ministria për Energjetikë dhe Miniera në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkesa për transferin e mjeteve të Ministrisë së Energjetikës dhe e Minierave për transferin e mjeteve, në shumën prej 1.000.000,00 €, në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit për programin e transmissiionit KOST në kategorinë e investimeve Kapitale, shtyhet për seancën e ardhshme.
2. Kërkohet nga Ministria e Energjetikës dhe e Minierave t'i paraqesë Kuvendit dokumente (dëshmi) shtesë, sipas kërkesave të deputetëve gjatë debatit, lidhur me transferin e mjeteve të kërkuara.

16. Shqyrtimi i rekomandimit lidhur me Raportin fiskal për gjashtëmujorin e parë të vitit 2007

Kryetari e ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa ta arsyetojë Rekomandimin lidhur me Raportin fiskal.

Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha se Raporti është hartuar me një teknikë më të përparuar krahasuar me ata të mëparshmit. Raporti është më i specifikuar dhe më i detajizuar për organizatat buxhetore. Mirëpo, atij i mungojnë disa tregues, që paraqesin progresin ndaj planit aktual. Po ashtu, i mungojnë analizat dhe komentet, ndërsa disa shpenzime duhet të paraqiten si pozicione në mënyrë të veçantë, siç janë shpenzimet lidhur me statusin e Kosovës.

Me vërejtjen që raportet e ardhshme të përcillen të plotësuara me analiza dhe komente, që do ta plotësonte një pasqyrë reale për rrjedhën e parasë publike, i rekomandoi Kuvendit që për shpenzimet e periudhës përfundimtare, të këtij viti, të kërkojë llogari nga Qeveria, si dhe ta miratojë Ligjin mbi auditimin e jashtëm

Kryetari e ftoi ministrin e Financave ta arsyetojë Raportin fiskal për gjashtëmujorin e parë të vitit 200 para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Haki Shatri** tha se Ministria në pajtim me dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë paraqet para Qeverisë dhe Kuvendit Raportin periodik të 6 mujorit.

Të hyrat janë rezultat i aktivitetit të Shërbimit Doganor, në veçanti i kontrollit më rigoroz të hyrave, i hyrjes së mallrave në veri të vendit. Pra, janë arritur rezultate mbi parashikimet e buxhetit.

Po ashtu, pjesa e të hyrave që është realizuar nga Administrata Tatimore, është rezultat i shtrirjes së veprimtari të saj. Nuk ka pasur ndryshim të politikave, të tarifave dhe të taksave, por ka pasur një aktivitet që është shtrirë në vijën horizontale, duke i përfshirë edhe ato ndërmarrje që janë obligues tatimor, të cilat në periudhat e deritashme iu kanë shmangur obligimit ndaj buxhetit.

Shpenzimet si kategori e veçantë e këtij Raporti nuk kanë pasur shmangie nga kategoritë e veçanta, në veçanti te pagat dhe mëditjet janë afër dinamikës së paraparë. Po ashtu, mallra dhe shërbimet janë pak nën dinamikën kur pjesëtohet gjysma e vitit me gjysmën e mjeteve të destinuara për këtë qëllim, dhe shërbimet komunale janë 50% ose janë në përputhje me dinamikën e paraparë.

Brengë e veçantë për periudhën e 6 mujorit të parë kanë qenë shpenzimet kapitale, të cilat janë realizuar diku rreth 20% të shumës së paraparë për vitin 2007.

Të dhënat për 8 muaj janë edhe më inkurajuese dhe rezultatet janë edhe shumë më të avancuara, qoftë te kategoria e të hyrave buxhetore, qoftë te shpenzimet buxhetore, ku janë realizuar 66% e të hyrave buxhetore vjetore për 8 muaj dhe rreth 200 milionë euro, para të cilat do të mund të parashihen në shpenzimet e buxhetit për vitin 2008, si të hyra të veçanta dhe do të sistemohen në shpenzimet, në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Gjithashtu, shpenzimet në të gjitha kategoritë janë në përputhje me kohën dhe më duhet të them që, kur përfshihen 8 muaj, pra edhe dy muaj shtesë që i kemi ndërmjet 6 mujorit dhe ditës së sotme, rezultati është shumë më i kënaqshëm dhe sillet diku rreth 30% të shpenzimeve kapitale.

Procedurat janë pak të ngatërruara dhe si pasojë pagesat gjithmonë vonojnë, sepse realizuesit e projekteve kapitale njëherë duhet ta realizojnë punën në terren, pastaj të paraqesin faturat për pagesë, kështu që gjithmonë pagesa bëhet pasi që të kryhet puna.

Pastaj, **kryetari** e hapi diskutimin lidhur me Raportin në fjalë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadërgjonaj**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Mazllom Kumnova** dhe emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Nazim Jashari**, si dhe deputetët: **Behxhet Brajshori**, **Gani Koci**, **Selviqe Halimi** dhe **Jakup Krasniqi**, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, ministri **Shatri** iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve.

Kryetari e mbylli debatin pa votim.

17. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit të Bordit Drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës

Kuvendi, pasi e shqyrtoi propozimin e Qeverisë së Kosovës, mori këtë

V E N D I M

1. Gazmend Luboteni emërohet anëtar i Bordit Drejtues të Autoritet Qendror Bankar të Kosovës.
2. Vendimi i procedohet PSSP-së për veprime të mëtejme.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 15: 50 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë Berisha

E hartoi:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale